

# RAPORTET FINANCIARE

PER VITIN QE PERFUNDON ME 31.12.2012

---

## QKSS

Prishtinë, Mars 2013

---

## PERMBAJTJA

1. BILANCI I GJENDJËS
  2. PASQYRA E TË ARDHURAVE
  3. PASQYRA E NDRYSHIMVE NE EKUITETIN E AKSIONARËVE
  4. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
  5. SHPALOSJA
-

## 5. SHPALOSJA

### BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

#### 5.1. Baza e përgatitjes dhe prezentimit

Pasqyrat financiare të kompanisë janë të përgatitura sipas parimit të kostove historike në përputhje me ligjet tatimore në Kosovë dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

#### 5.2. Valuta e paraqitur

Pasqyrat Financiare janë të prezentuara në Euro ( "EUR"), e cila është valuta legale që përdoret në territorin e Kosovës.

#### 5.3. Pajtueshmëria e pasqyrave

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

#### 5.4. Përmbledhja e politikave të rëndësishme të kontabilitetit

Përmbledhja e politikave kryesore të kontabilitetit të adoptura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezentuara më poshtë.

##### 5.4.1 Mjetet themelore

Mjetet themelore janë të paraqitura më vlerën neto të mjeteve. Asetet e prekshe janë zhvlerësuar në momentin kur janë përdorur.

Kur vlera e asetit është më e vogël se vlera aktuale e vlerësuar, vlera e tij zhvlerësohet në vlerën e tij të ripërritshme dhe diferenca ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave. Zhvlerësimi zbatohet me metodën drejtëvizore dhe është i llogaritur në vlerën historike të mjetit, në tërë jetëgjatësinë e asetit, llogaritja e shkallës së zhvlerësimit është bërë në përqindje.

Zhvlerësimi sipas kategorive vijuese (*Ligji Nr. 03/L-162, Neni 15 – Zhvlerësimi*):

**Kategoria 1 (5%):** Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;

**Kategoria 2 (20%):** Automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë; dhe bagëtitë të shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;

**Kategoria 3 (10%):** Uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave si p.sh. mollët, dardha, arrat, boronicat dhe te tjera ; dhe të gjitha asetet e trupëzuara që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo kategorinë 2.

Zhvlerësimi individual i pasurisë të Kategorisë 2 dhe Kategorisë 3 do të zbatohet vetëm për ato pasuri të cilat janë marrë në apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Blerja e një pasurie për çmimin prej 1,000 euro ose më pak do të lejohet si një shpenzim rrjedhës.

Pasuria (mjetet) kapitale që janë blerë dhe ka filluar zhvlerësimi i tyre sipas metodës grupore para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zhvlerësohen sipas legjislacionit paraprak derisa vlera e grupit të bëhet zero.

Zhvlerësim përdoret me metodën lineare. Duke pasur parasysh normat e zhvlerësimit për secilën kategori të asetëve, kjo do të thotë se Kategoria 1 e asetëve të reja (norma e zhvlerësimit 5%) do të zhvlerësohet në shumën e barabarta gjatë 20 periudhave tatimore, Kategoria 2 e asetëve të reja (Shkalla

---

e zhvlerësimit 20%) do të zhvlerësohen në shuma të barabarta gjatë 5 periudhave tatimore, dhe Kategoria 3 e asetëve të reja (norma e zhvlerësimit 10%) do të zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 10 periudhave tatimore.

Asetet e prekshme me çmim të blerjes prej më shumë se 1,000 euro dhe më pak se 3,000 euro, të siguruara pas datës në të cilën ky ligj hyn në fuqi, do të vendoset në një grup të vetëm të asetëve dhe do të zhvlerësohet me shkallën 20% të vlerës së asetëve në grup, pa marrë parasysh në cilën kategori të asetëve do të vendosej. Kur asetet kualifikuese janë blerë, çmimi i tyre i blerjes do të shtohet në vlerën e grupit. Kur asetet të jenë shitur nga grupi, çmimi i blerjes së asetit të shitur do të raportohet si e ardhur e zakonshme afariste në vitin në të cilin asetit është shitur, por vlera e grupit nuk do të ulet si rezultat i shitjes.

#### **5.4.2 Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshin paranë në bankë dhe paranë e gatshme. Për qëllimet e rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë përbëjnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

#### **5.4.3 Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme janë të mbajtura në vlerën e faturuar duke zvogëluar me provision për shlyrjet. Provisioni për shlyrjet për llogaritë e arkëtueshme ku ka dëshmi se kompania nuk do të mund ti mbledh të arkëtueshmet në bazë të vlerës fillestare të faturuar. Vështirësitë e mëdha financiare të borxhliut, mundësia që borxhliu të falimentoj, dhe vonesat e shpeshta në pagesat janë konsideruar si tregues për zhvlerësimin e kërkesave.

#### **5.4.4 Vlerësimi i të hyrave**

Të hyrat maten më vlerën e drejtë të pranuar apo priten të inkasohen. Të hyrat e llogaritura janë të zvogëluara për kthimin e shitjeve, rabatit dhe zbritjeve të tjera të ngjajshme.

#### **5.4.5 Tatimi - Shkalla e tatimit**

**TAK** - Tatimi në të ardhurat e korporatave është dhjetë për qind (10%) e të ardhurave të tatueshme (*Ligji Nr.03/L-162, Neni 6 – Shkalla tatimore*). Fitimi i tatueshëm bazohet nga fitimi i raportuar në pasqyrën e të ardhurave duke përjashtuar zërat e të hyrave ose shpenzimeve të cilat ju takojnë viteve tjera dhe duk përjashtuar zërat e tjera të cilat janë të përjashtuar nga taksat ose të zbritshme.

Për të ardhurat e tatueshme në periudhat tatimore para 1 Janarit 2009, tatimi në të ardhurat e korporatave është njëzet për qind (20%) e të ardhurave të tatueshme në përputhje me legjislacionin që ka qenë në fuqi.

**TVSH** – Tatimi Mbi vlerën e Shtuar ngarkohet me normën prej 16 % (*Ligji Nr. 03/L-146, Neni 26 - Norma*).

#### **5.4.6 Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshmet tjera**

Detyrimet për shumatat e të pagueshmeve tregëtare janë bartur me koston e tyre.

#### **5.5. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT**

Menaxhmenti nuk është në dijeni për ngjarje të cilat kanë të ngjarë pas datës së bilancit të gjendjes dhe që mund të kenë ndikim apo kërkojnë shpallje në pasqyrat financiarë të kompanisë me datë 31 Dhjetor 2012.



QKSS  
Prishtine  
600278685


Pasqyra e Bilancit më 31 Dhjetor 2012

(në Eur)

pozicioni	Përshkrimi	Shënimet	2012
1	Pasuritë		
2	Pasuritë qarkulluese te tanishme:		
3	Paratë e gatshme (në bankë dhe në arkë)		24,494.60
4	Llogaritë e arkëtueshme		-
5	Stoqet		-
6	Shpenzimet e parapaguara		-
7	Kerkesat e tjera		4,058.34
8	Totali i pasurive te tanishme		28,552.94
9	Pasuritë themelore- të përhershme:		
10	Toka		-
11	Ndërtesat		-
12	Paisjet dhe makineria		-
13	Pasuritë e paprekshme		-
14	Invesimet afatgjate		-
15	Pasurite e tjera		-
16	Totali i pasurive themelore		-
17	<b>GJITHSEJ PASURIA</b>		<b>28,552.94</b>
18	Detyrimet dhe ekuiteti		
19	Detyrimet afatshkurtëra:		
20	Llogaritë e pagueshme		530.21
21	Te hyra te shtyera		28,291.18
22	Detyrimet per avanse		-
23	Tatimi mbi fitim i pagueshëm		-
24	Detyrimet e tjera afateshkurtër		-
25	Totali i detyrimeve te tanishme		28,821.39
26	Huatë afatëgjate		-
27	Detyrimet e tjera jokurente		-
28	Totali i detyrimeve afatgjate		-
29	<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>28,821.39</b>
30	<b>Kapitali dhe rezervat:</b>		
31	Kapitali vetanak		
32	Fitimi /Humbja e mbajtur		
33	Fitimi /Humbja e vitit afarist		(268.45)
34	Totali i ekuitetit		(268.45)
	<b>GJITHSEJ DETYRIME DHE EKUITET</b>		<b>28,552.94</b>

Prishtinë  
Dt.22.03.2013

Përgatiti,




QKSS  
Prishtine  
600278685

Pasqyra e të Ardhurave  
për vitin e përfunduar më 31.12. 2012

(në Euro)

Pozicioni	Përshkrimi	Shënimet	2012
1	Te hyrat nga Projektet		95,464.81
2	Lejimet ne shitje		-
3	Shitjet e kthjera		-
4	Shitjet neto		95,464.81
5	Kosto e mallërave te shitur		
6	Fitimi Bruto		95,464.81
7	<b>Shpenzimet operative</b>		
8	Shpenzime materiale		-
9	Shpenzimet e energjis		-
10	Shpenzimet nga regjistrimet kontabel		(26,120.55)
11	Shpenzimet e personelit		(59,087.21)
12	Zhvlersimi i mjeteve themelore		-
13	Shpenzimet e sherbimeve transportit		-
14	Shpen.telefo,komunale,qiras,donac.		(9,798.00)
15	Shpen.udhetime zyrtare, reprezen,mirembajtjes		-
16	Shpenz.sigurime,shpedicion,antarsi		-
17	Shpenzimet e reklamuese		-
18	Shpenzimet per sherbime tjera		-
19	Shpenzimet e qarkullit te pagesave		(459.05)
20	Shpenzimet tjera te pa zbritshme		-
21	Totali i shpenzimeve operative		(95,464.81)
22	<b>Fitimi/Humbja operativ(e)</b>		-
23	Të hyra nga interesi		-
24	Të hyra nga ndryshimet e kursit		-
25	Të hyra të tjera financiare		-
26	Totali i të hyrave financiare		-
27	Shpenzimet e interesit		-
28	Humbjet nga ndryshimet e kursit		-
29	Të dala të tjera financiare		-
30	Totali i shpenzimeve financiare		-
31	Fitimi/Humbja nga aktivitetet financiare		-
32	<b>Fitimi/Humbja para tatimit ne fitim</b>		-
33	Shpenzimet e tatimit në fitim		
	<b>Fitimi/Humbja neto për vitin</b>		-

Prishtinë  
Dt.22.03.2013

Përgatiti,   
Drejtori, Florian Cehajci

QKSS  
Prishtine  
600278685


Pasqyra e ndërrimeve në ekuitet  
për vitin e përfunduar më 31.12. 2012

(në Eur)


Pozicioni	Përshkrimi	Kapitali aksionar	Rezervat ligjore	Rezervat e rivlersuara	Fitimet e mbajtura	Totali
1	Bilanci më 01.01 2011	-	-	-	-	-
2	Fitimi ose Humbja neto per periudhen	-	-	-	-	-
3	Dividendate pagueshme	-	-	-	-	-
4	Bilanci më 01.01. 2012	-	-	-	-	-
5	Diferenca nga rivlersimi	-	-	-	-	-
6	Emetimi i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
7	Fitimi ose Humbja neto per periudhën	-	-	-	-	-
8	Kalimi i rezervave ligjore ne fitimin e mbajtur	-	-	-	-	-
9	Dividentat	-	-	-	-	-
10	Bilanci më 31.12.2012	-	-	-	-	-

Prishtinë  
Dt.22.03.2013

Pergatiti,



Drejtori,



QKSS  
Prishtine  
600278685

Pasqyra e rrjedhës së parasë  
për vitin e përfunduar më 31.12. 2012

(në Eur)

Pozicioni	Përshkrimi	Shënimet	2012
1	Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
2	Paratë e arktuara nga konsumatorët		121,580.76
3	Paratë e paguara furnitorve dhe të punësuarve		(93,289.58)
4	Paraja e gjeneruar nga afarizmi		-
5	Interesi i paguar		-
6	Tatimi në të ardhura i paguar		-
7	Paratë neto nga aktivitetet operative		28,291.18
8	Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
9	Blerja e pasurisë së patunshme, impianteve dhe paisjeve		-
10	Rezultati i shitjes së pasurive fikse		-
11	Interesi i arkëtuar		-
12	Dividenda e pranuar		-
13	Paraja neto e përdorur në aktivitete investuese		-
14	Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		
15	Rezultati nga rritja e kapitalit akcionar		-
16	Rezultati nga huazimi afatgjatë		-
17	Pagesa e detyrimeve të huas financiare		-
18	Dividenda e paguar		-
19	Paraja neto e përdorur në aktiviteteve financiare		-
20	Rritja/Zvoglimi neto e parasë së gatshme		28,291.18
21	Paraja në fillim të periudhës		-
22	Paraja në fund të periudhës		28,291.18

Prishtinë  
Dt.22.03.2013

Përgatiti,